



**Shtyhet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,  
në AGH University of Science and Technology, Poloni**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në AGH University of Science and Technology, Poloni.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).

**Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor - 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023 - 2024)
- Master - 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023 - 2024)

**Fushat e studimit:** Të gjitha degët (Studentë e interesuar të shohin lëndët që ofrohen në AGH University of Science and Technology, në linkun e mëposhtëm).

**Numri total i studentëve:** 5 studentë

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.



**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

---

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në AGH University of Science and Technology lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni te:

[Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

*Për t'u njohur me lëndët që ofrohen në AGH University of Science and Technology, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-et:*

- [Education offer \(agh.edu.pl\)](https://agh.edu.pl)
- [AGH UST Syllabus](#)

**Afati për aplikim: Deri më 6 nëntor 2023, ora 12.00**

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al) , [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al)